

Ivana Dobrivojeviq
Goran Milloradoviq

Shteti i kërcënuar?

Terrorizmi në Mbretërinë e Jugosllavisë





Pyetja kyçe

A mendoni se mund të arsyetohet përdorimi i metodave terroriste për arritjen e qëllimeve politike?



Tema

Ky modul e hulumton fenomenin e terrorizmit në Mbretërinë e SKS/Jugosllave në periudhën 1919-1934. Temën e zgjidhën sepse dëshironim ta theksojmë luftën mes organizatave terroriste dhe institucioneve shtetërore në shoqërinë e cila lufton për demokraci. Kontroversa gjenden në perceptimet e ndryshme të organizatave terroriste. Përderisa shteti, elitat politike dhe shumica e popullsisë në mënyrë të fuqishme e kundërshtojnë terrorizmin, pakica i konsideron “luftëtarë për liri”.



Rezultatet e mësimit:

1. Nxënësit do ta njohin terrorizmin si mjet për arritjen e qëllimeve politike.
 2. Analiza e burimeve historike.
 3. Njohja e lidhjes mes rrethanave politike dhe terrorizmit.
 4. Krahasimi i terrorizmit dikur dhe sot.
-



Qëllimet

Nxënësit do të fitojnë njohuri për aktivitetet terroriste të grupeve të ndryshme politike në Mbretërinë Jugosllave.

Udhëzime për mësime të mëtejshme



90
minuta

Mësuesi do ta lexojë hyrjen dhe to ta sqarojë termin terrorizëm

Hapi 1: Nxënësit njihen me temën nëpërmjet kontekstit dhe pyetjeve, marrin burime për grupin e tyre dhe të gjitha fotografitë.

Hapi 2: Ndarja e nxënësve në grupe dhe analiza e burimeve.

Hapi 3: Prezantimi i konkluzioneve të secilit grup.

Hapi 4: Diskutim.

Hapi 1

Stuhia e ideve

Sqarimi i termeve

Interpretimi teorik i terrorizmit

Termet kyçe: sundimi i dhunës, persekutimeve, rrezikimi fizik dhe zhdukja e kundërshtarit, sundimi i frikës;

Terrorizëm: shfrytëzimi sistematik i dhunës dhe frikësimit për qëllime politike ose për shkak të nxjerrjes zhvatjes së parave;

Terrorist: ai që kryen terror, pjesëtari i organizatës terroriste.

Ivan Klajn, Milan Šipka, Veliki rečnik stranih reči i izraza, Novi Sad 2006.

Hyrje

Jugosllavia (Mbretëria e SKS) është krijuar në dhjetor të vitit 1918, dhe është njohur në Konferencën e Paqes në Versajë në vitin 1919.

Jugosllavia përfaqësonte pjesë të zgjedhjes për sigurinë në Evropë pas Luftës së Madhe. Nga Deti Baltik deri në Detin Mesdhe është formuar brezi i shteteve të reja të cilat ishin nën mbrojtjen e fuqive fitimtare në Luftën e Parë Botërore. Detyrat kryesore të atij “brezi të sigurisë” ishin: pengimi i ekspansionit sovjetik në Evropë, parandalimin e revanshizmit të shteteve të mëparshme, rezistenca ndaj ekspansionizmit italian në Ballkan.

Si pjesë e të ashtuquajturit “sistem francez”, Jugosllavia i kryente të tre detyrat.

Sidoqoftë, në periudhën mes luftërave Jugosllavia rrezikohej seriozisht nga Italia, BRSS-ja dhe Gjermania (pas shfaqjes së Hitlerit). Hungaria, Bullgaria dhe Shqipëria, të pakënaqura nga epilogu i Luftës së Parë Botërore dhe marrëdhëniet aktuale ndërkombëtare, i përkrahnin vazhdimisht këto grupe nacionaliste që ishin të pakënaqura me krijimin e Jugosllavisë dhe kufijtë e vendosur. Nacionalistët ekstremë në Jugosllavi përkraheshin fuqishëm nga Italia dhe më vonë (në vitin 1930) gjithashtu nga Gjermania. Dhe në anën tjetër, komunistët kishin përkrahje të fuqishme nga BRSS-ja. Faktorë të ndryshëm, duke përfshirë organizata terroriste, të pakënaqur me shtetet e reja krijonin një lloj “fronti” brenda kufijve të shtetit.

Kundërshtarë më aktivë të shtetit ishin partia Komuniste, VMRO-ja dhe Ustashët.

Sulmet terroriste në Jugosllavi e arritën kulmin e tyre gjatë viteve të 1930-ta.

Pyetje (stuhi idesh):

1. Çka mendoni çka është terrorizmi?
2. Sipas mendimit tuaj, cili është dallimi mes terrorizmit dhe luftëtarëve të lirisë?
3. Përpiqu të sqarosh pse personat e njëjtë mund të cilësohen si terroristë në një vend dhe si luftëtarë të lirisë në një tjetër. Përpiqu të mendosh disa shembuj.
4. Cilat janë efektet (negative) të terrorizmit?
5. Si i përgjigjet shteti zakonisht terrorizmit?
6. A jeni në dijeni të shembullit të sotëm të ndonjë organizate terroriste dhe akti terrorist?

Burimi 1

Aksioni i komitëve* maqedonas (1919-1934)

“Statistika e aksioneve terroriste nga kjo anë e kufirit tregon se gjatë periudhës na vitit 1919 deri në vitin 1934 në territorin jugosllav janë kryer 467 sulme, aksione terroriste dhe të ngjashme, të cilat i organizoi V.M.R.O.**, gjatë të cilave janë vrarë ose plagosur 253 qytetarë – viktima të pafajshme.

T'i kujtojmë vetëm disa nga aksionet terroriste: masakra e fshatarëve në fshatrat Kadrifalkovë dhe Sushevë, të cilat morën 35 jetë njerëzish, vrasja e gjeneralit Mihajlo Kovaçević në Shtip dhe vrasja e dhjetëra oficerëve të tjerë dhe kufitarëve me grada të ndryshme; gjithashtu 10 sulme terroriste në objektet publike (kafene dhe restorante) të cilat morën 94 jetë, dhe 28 sulme të tjera të drejtuara kundër hekurudhës dhe pronës së saj.”

*Komitët-njësitet ushtarake të VMRO-s

**VMRO-Organizata e Brendshme Revolucionare Maqedonas (OBRM) është themeluar në fund të vitit 1893 në Selanik. E pakënaqur me Marrëveshjen e re paqësore, organizata u përpoq t'i ndryshojë kufijtë në Ballkan duke shfrytëzuar metoda terroriste.

“Raport për rezultatet e aksioneve të komitëve maqedonas”, 01.12.1934
AJ (Archives of Yugoslavia), 37 (Milan Stojadinovic) – 22 - 174

Burimi 2

Sulmet terroriste të VMRO-së

“Gjatë natës mes 30 dhe 31 maj 1932 në Beograd u vendosën 4 bomba edhe atë: në rrugën Millsh Pocerc, në ndërtesën e papërfunduar të administratës së qarkut për sigurimin e punëtorëve në rrugën Nemanjina, në ndërtesën e gjimnazit II të djemve dhe në shtypshkronjën Gjura Jakshiq në afërsi të ndërtesës së re të kuvendit në rrugën Mbreti Aleksandër, prej të cilave vetëm e dyta dhe e katërta eksploduan... ndërsa dy të tjerat u vërejtën në kohë dhe u demontuan. Gjatë ditës së 30 shtatorit 1932 erdhi në Shtëpinë e Oficerëve korrieri Kresović Gjura duke mbajtur një bufer të vogël. Shërbyesja Spasenia Bozhiq, e cila atje i pastronte shkallët, e pyeti korrierin cilin e kërkon, ndërsa ai i tha që nga një zotëri në rrugë morri urdhër që me atë valixhe ta pret kapitenin Ranković. Spasenia, duke mos e njohur atë kapiten, e drejtoi kapitenin në bahçe, që të pret atje, dhe ai doli për një kohë, ndërsa më vonë sërish u kthye në paradhomë, duke i thënë asaj që nuk mund të pretë, dhe që pas një kohe të shkurtër do të kthehet këndej. Pastaj Kresović u drejtuar nga dera që të del. Në atë moment në korridor ndodhi një eksplodim i fuqishëm... i shkaktuar pas eksplodimit të bombës e cila ndodhej në valixhe. Korrieri Kresović ra i goditur për vdekje dhe për një kohë të shkurtër pas kësaj vdiq nga lëndimet e mara, ndërsa Spasenija Bozhiq... u lëndua rëndë. Ky eksplodim ndërtesës dhe inventarit i bëri dëm prej 122.770,24 dinarë, siç u vërtetua më vonë. Korrierit Kresović eksplodimi ia këputi të dyja këmbët, ia këputi enët e gjakut në këmbë dhe në dorën e djathtë, dhe kështu ndodhi gjakderdhje e madhe pas së cilës Kresović vdiq pa u hetuar për veprën dhe organizatorin.”

AJ, 135 (Drzavni sud za zastitu drzave) – 100 – 38 / 33.

Burimi 3

Luftë e vazhdueshme me intensitet të vogël në kufirin jugosllavo – bullgar?

“Rreth orës 22 kufitarët tanë bënë luftë me banditët të cilët përpiqeshin ta kalojnë territorin tonë. Bandat i ndihmonin edhe kufitarët bullgarë. Lufta u zhvillua te karakolli Javor Çuka në afërsi të vet kufirit... në drejtim të qarkut të Bosilgradit. Në luftime u përdorën pushkët, bombat dhe mitralozat. Luftimet zgjatën 15 minuta. Banditët u tërhoqën nën presonin e zjarrit të mitralozave... forca e çetës ishte pesë njerëz. Sipas informatave të cilat i kam, komitët do të mundohen të kalojnë në anën tjetër të qarkut të Kriva Pallankës apo Bosilgradit. Janë marrë masa. Xhandarët me milicinë në terren”.

Nezavedeno, bez naslova, iz 1933; AJ, 74 (Dvor) – 50 - 68.

Burimi 4

Efektet financiare të fushatës së VMRO-së

“Protesta të panumërta në Sofje në të cilat kërkohen që Qeveria Bullgare ta kontrollojë fushatën terroriste të VMRO-së mbetën pa rezultate. Qeverisë Jugosllave për shkak të kësaj nuk i mbeti asgjë tjetër përveç se ta sigurojë territorin e saj nga sulmet dhe t’i mbrojë jetët e qytetarëve të saj, duke e fortifikuar thuajse tërë kufirin me Bullgarinë, rreth 400 km, me shpenzime të larta (rreth 200 milionë dinarë). Kështu, forcimi dhe mbikëqyrja e vazhdueshme mbi kufirin, linjat hekurudhore dhe ndërtesat publike në hapësirat e afërsisë së kufirit bullgar kërkonin mjetet të konsiderueshme financiare (rreth një miliardë dinarë gjatë pesëmbëdhjetë viteve).”

“Raport për rezultatet e aksioneve të komitëve maqedonas”, 01.12.1934 (Arkivi i Jugosllavisë), 37 (Milan Stojadinoviq) – 22-174

Burimi 5

Vrasja e mbretit Aleksandër

“Mbreti Aleksandër u vra më 9 tetor në Marsejë, disa minuta pasi që zbriti nga anija komanduese “Dubrovnik”, me të cilën lundroi nga Jugosllavia. Për shkak të neglizhencës së paparë kriminale të autoriteteve franceze, lartmadhëria e tij, bashkë me ministrin francez të punëve të jashtme Bartou, lehtësisht iu sakrifkuan vrasësit, i cili në ndërkohë është identifikuar si pjesëtar i Organizatës Revolucionare Maqedonase (VMRO) dhe që është e sigurt... përfaqësonte vegël në duart e atyre refugjatëve kroatë të cilëve Italia dhe Hungaria në 7 vitet e kaluara u ofronte strehim dhe mikpritje. I armatosur me revole automatike, vrasësi arriti të depërtojë nëpër kordonin e rrallë të policëve dhe gardistëve, të cilët qëndronin në distancë prej përafërsisht katër metra e gjysmë nga njëri tjetri, dhe të ngjitet në platformën e automobilit mbretëror dhe të gjuajë rreth njëzetë plumba, para se ta kositë oficeri i kalorësisë i grupit të sigurisë. Masa më pas e linçoi atë”.

Raporti vjetor i Nevil Hendersonit, të dërguarit britanik në Beograd për vitin 1934, Z. Avramovski, Britanci o Kraljevini Jugoslaviji, t II, Zagreb 1988, 263..

Pyetje për Grupin 1

1. Cilat ishin aktet terroriste të VMRO-së?
2. Si ndikuan aktet terroriste në jetën e njerëzve të thjeshtë?
3. Në kohën e depresionit të madhe ekonomik, terrorizmi dhe lufta kundër terrorizmit shkaktuan humbje të mëdha financiare dhe investime të mëdha ushtarake. Përpiku të sqarosh pse.

Burimi 1

Qëllimet e ustashëve

“Bombat janë të nevojshme, ata janë të dobishme, ata janë imperativ i kohës, me ato, pajisjet eksplozuese, me gjuajtjet vrasëse duhet të tronditen muret e paqëndrueshme të kullës e cila quhet Jugosllavi. Le të kërcasin bombat, le të jehojë zëri i tyre nëpër Kroaci dhe përtej saj, le të jetë numri i tyre sa më i lartë” (Dr. Branimir Jeliq, njëri prej udhëheqësve të Organizatës së Ustashëve)”

Gric. Evropski prilog Hrvatskog domobrana, 4. 06 1932; AJ, 38 (CPB) – 114 – 565.

Burimi 2

“Është detyrë e ustashëve për t'u hakmarrë. Por jo me masën e njëjtë. Ustashë, mbajeni mend, masa e ushtashëve është: për dhëmbin – kokën, për kohën – dhjetë koka! Kështu thotë ungjilli i ustashëve.”

Ustasa, 06. 1932, AJ, 135 - 105 - 53/33.

Burimi 3

“Edhe pse shoqata e ustashëve i ka vendosur vetes si qëllim përfundimtar shpërbërjen e një pjese të Mbretërisë Jugosllave nga tërësia shtetërore, ajo nuk synon ta arrijë atë qëllim me mjetet e luftës politike, qoftë edhe ilegale, por aksionin e saj e ka drejtuar në drejtim që të frikësojë me anë të terrorizmit masat e gjera të popullit me anë të atentateve, vrasjeve të personave të theksuar dhe rrënimin e objekteve publike me materiale eksplozuese, veçanërisht me personat e theksuar dhe rrënimin e objekteve publike me materiale eksplozive, veçanërisht instalimeve të komunikimit publik dhe mjeteve ku vjen në shprehje dëmi material, lëndimet trupore dhe vrasjet që cilat nuk kanë asnjë lidhje me politikën”.

AJ, 135 – 114 – 37 / 34

Burimi 4

Aksionet terroriste të ustashëve

Në fillim të gushtit (1931) erdhi deri te një sërë eksplozimesh të bombave në trenat të cilat vinin nga Austria. Në natën e 2 gushtit, bomba eksplozoi në trenin e shpejtë Minhen – Beograd, i cili kaloi nëpër Austri. Deri te eksplozimi erdhi kur treni qëndronte në Zemun, në stacionin e fundit para hyrjes në Beograd. Dy meshkuj të rritur dhe një djalosh u vranë, ndërsa një grua u plagos për vdekje. Autoritetet e hekurudhave jugosllave menjëherë vendosën që në kufij t'i ndalin të gjithë udhëtarët e vagonëve të cilët vinin nga Austria, dhe në ditën e ardhshme zbuluan eksplozivë në dy vagonë, në Jesenicë në kufirin austriak. Vagonët u mënjanuan në binarët dytësorë, por gjatë kërkimit nuk u gjetën edhe dy bomba të cilat ishin fshehur pas ulëses dhe të cilat eksplozuan disa orë më vonë.”

Raporti vjetor i Nevil Hendersonit, të dërguarit britanik në Beograd për vitin 1931, Z. Avramovski, Britanci o Kraljevini Jugoslaviji, t II, Zagreb 1988, 26.

Burimi 5

“Si rezultat i një serie të gjatë të eksplozimit të bombave të cilat i vrisnin udhëtarët dhe i shkatërronin vagonët, asnjë vagoni të huaj gjatë të mërkurës nuk iu lejua ta kalojë kufirin jugosllav. Udhëtarët në të gjitha trenat e vendeve të huaja, përveç të trenit të shpejtë nga Italia, ishin të obliguar që zhvendosen në trenat jugosllavë.”

“Jugo – Slavian Bar Foreign Rail Cars to Quell Bombing”, Journal, Atlanta, 6. 8. 1931; AJ, 38 – 414 – 565.

Burimi 6

Aktivitetet terroriste të ustashëve

“Si pasojë e organizimit dhe e trajnimit të ustashëve erdhi deri te një sërë e akteve terroriste të kryera në Jugosllavi. Si më të rëndësishme i përmendi: vrasja e Toni Shlegerit, drejtorit të gazetës “Novosti” në Zagreb, vrasja e agjentit policor Josip Kec dhe tentimi i vrasjes së agjentit të policisë Josip Ban, i cili është plagosur rëndë; vrasja e agjentit të policisë Matija Trebski dhe përpjekja e vrasjes së agjentit policor Frank Bllagoviq - kjo është kryer në vitin 1929. Më pas, në vitin 1930, përpjekja e atentatit me pajisje eksplozuese në hekurudhën Strizivojna – Vrpolje – Mihanovci (pajisja eksplozuese është dashur të eksplozojë gjatë kohës së kalimit të trenit me të cilin shkonin në Zagreb përfaqësuesit e partisë fshatare). Pas kësaj, në vitin 1931 vjen eksplozimi i pajisjes shpërthyesë në ndërtesën e njësish administrative në Zagreb dhe vrasja e Andrija Beriqit, kryetarit të komunës në Nova Gradishka. Në vitin 1932 vijon eksplozimi i pajisjes shpërthyesë në vagonin e klasës II në linjën Osijek – Vinkovinci, eksplozimi i pajisjes shpërthyesë në hekurudhën Beograd – Zagreb... dhe eksplozimet në Zagreb përpara kishës ortodokse dhe në oborrin e regjimentit XXXII të këmbësorisë. Në vitin 1933 vjen... eksplozimi i pajisjes shpërthyesë në komisariatit policor në Koprivnicë, prej nga u vra një agjent policie, ndërsa dy të tjerë u lënduan rëndë. Pas kësaj vjen vrasja e ministrit të mëparshëm të deputetit popullor Mirko Najdorfer në Zllatar... eksplozimi i pajisjes shpërthyesë në Gola, eksplozimi i pajisjes shpërthyesë në hekurudhën në Zapreshiq etj...”

E paregjistruar, pa titull, nga vitit 1931; AJ, 38-103-240 103 - 240

Pyetje për Grupin 2

1. Duke i përdorur burimet përpiku të sqarosh pse nacionalistët ekstremë ëndërronin për shpërbërjen e Jugosllavisë?
2. Duke i analizuar burimet, përpiku të gjesh ngjashmëri mes terrorizmit sot dhe organizatës së ustashëve?
3. Cilat burime na tregojnë bashkëpunimin eksplicit mes dy organizatave terroriste?
4. Duke i shfrytëzuar burimet e dhëna, përpiku të përfundosh cilat vende (në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë) e përkrahnin organizatën e ustashëve?

Burimi 1

“Protestë e Maqedonisë së përvuajtur”

Populli i robëruar maqedonas në shtetin e mbretit Aleksandër Karagjorgjeviq përjeton ditë të vështira. Ai në mënyrë të heshtur është lënë jashtë ligjit. Atë e rrahin pa gjyq dhe gjykim, e shtypin dhe plaçkitin pa asnjë ligj dhe të drejtë qytetare dhe njerëzore. Frika dhe trishtimi mbretëron sot në Maqedoni. Klika monarkiste dhe militariste në Beograd vendosi që me zjarr dhe shpatë ta ngulfat shpirtin maqedonas dhe në gjak ta ngufasë vetëdijen nacionale maqedonase. Çdo ditë bien kokat, çdo ditë policia dhe xhandarmëria i rrahin njerëzit në mes të rrugës. Çdo ditë maqedonasit e qetë merren nga shtëpitë e tyre, nga burgjet, që disa minuta më vonë të pushkatohen nga ana e xhandarëve të mbretit serb.

Asnjë siguri e jetës dhe pronës në Maqedoni sot nuk ekziston. Këto prona dhe vlera të maqedonasve sot i posedon policia dhe xhandarmëria. Të gjithë janë të dyshimtë, jeta e secilit është e rrezikuar. Askush nuk e di a do të jetë i gjallë kur bie nata dhe kur lind dielli. Beogradi hesht për tërë këtë. Përndryshe shtypi mërmëritës dhe i zhurmshëm serb ka rënë në heshtje varri për këto keqtrajtime të tmerrshme dhe vrasjet. Ai nëse informon diçka për këto krime të shumta, ua vesh ‘revolucionarëve’ protogerovistë nga Sofja (Bullgari). [...]

Populli gjendet në gjendje të dëshpëruar. Nga njëra anë Protogorov* i dërgon çetat e tija që të kryejnë atentate, prej të cilave çdoherë e pësojnë Maqedonasit e pafajshëm; në anën tjetër regjimi i tanishëm e shfrytëzon çdo aksion të atentateve, të suksesshëm apo të pasuksesshëm, që ta shtojë terrorin, i cili sjell vetëm të keqe. Dhe kështu, me çmimin e jetës sonë, bëhet grindja për atë se e kujt është Maqedonia, për çka vuajnë vetëm maqedonasit, edhe pse në të nuk janë pjesëmarrës dhe i dënojnë veprat e të dyja anëve”. [...]

**gjeneral Aleksandar Protogorov (1867-1928), ishte udhëheqës i organizatës VMRO.*

МАКЕДОНСКО ДЕЛО, В , 3, 25. 1928, . 58.

Burimi 2

Varfëria e një pjese të fshatarëve si njëri nga motivet për t’u bashkëngjitur ustashëve

“Biograd na Moru (Bigradi në det) ishte qytezë që kufizohet me Italinë fashiste... Njerëzit tanë atje mundohen me brenga të mëdha, në rend të parë, që të mos bien nën mashtrimin e fqinjit fashist, dhe brengë ende më të madhe ka se si ta ushqej vetveten dhe familjen e tij. Mjerimi, varfëria është shfaqur në qytezën Bigorad na Moru, populli nuk ka asnjë fitim, ku t’i shndërroj në para produktet e veta të farëra... Mund të shesë vetëm sot në qytetin italian Zarë, sepse ky qytet gjendet pranë pragut të shtëpisë. Qytetet tona janë shumë larg, më i afërt është Shibeniku, larg 100 kilometra, sepse hekurudhë nuk ka. Kjo varfëri e madhem kjo varfëri e vërtetë, kjo shkuarje e përhershme në Zarë për t’i shitur artikujt e tyre... është njëra nga arsyt kryesore që banorët ndjehen të mashtruar nga bijtë tanë tradhtarë... Këta... i mashtrojnë fshatarët e varfër që t’i marrin armët që ua dhanë (revole), t’i fshehin dhe ata të urdhërojnë, le t’i përdorin të njëjtit, sa për mbrojtjen e tyre, aq edhe për t’i ndihmuar ata, sepse së shpejti do të vijë çasti kur ata do të çlirohen nga varfëria e vështirë e cila i godet, se për ata do të vijë shpëtimi ekonomik, dhe gjithashtu sundimi më i mirë i cili do të ketë kujdes për të gjitha nevojat e tij dhe do t’u japë përparim më të mirë të jetës”.

Fjalimi i deputetit popullor Josip Antuniviq në mbledhjen e 42-të të rregullt të Kuvendit Popullor më 17 maj 1933, shënime stenografike të Kuvendit Popullor, Beograd 1933, 43. 43.

Burimi 3

“Populli i cili është mashtruar, tani vjen deri te përfundimi që kanë qenë të rrejshme premtimet të cilat i jepeshin... Është vërtetuar se elementet rebele të cilat ikën në Zarë, i premtuan banorëve të fshatit në rrethinën e Benkovacit dhe Biogradit se të gjithë ata të cilët do të marrin pjesë ose do ta ndihmojnë aksionin e ustashëve, pas suksesit të tij, si vullnetarë do të marrin tokë rreth Vranit, në pronë shtetërore të Sokolushës”.

Odmetsnicka akcija u Severnoj Dalmaciji (15. 2. 1933), AJ, 38 – 12 – 42.

Burimi 4

““Edhe pse disa gazeta me shkrimet e tyre krijuan përshtypje se Zagrebi është shtëpia e terrorizmit, publiku është thellësisht kundër kësaj”.

Raport i konsullit britanik Makrija nga Zagrebi i datës 26.12.1934. AJ, FO 371-409-19547.

Burimi 5

Memorandumi jugosllav drejtuar Lidhjes së Popujve (1934)

“Më 28 nëntor qeveria jugosllave dorëzoi pranë sekretarit të përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve memorandum me dokumente për pjesëmarrjen eventuale të autoriteteve hungareze. Ky memorandum mjaft i gjerë përmban, mes tjerash, edhe fajësimet vijuese: që terroristët në Hungari ishin të vendosur në llogore me dijen dhe miratimin e autoriteteve hungareze; që u ishin mundësuar lehtësime për bartjen e armëve, eksplozivëve dhe materialit propagandues në Jugosllavi; që nën qiell të hapur janë trajnuar të përdorin armët e zjarrit, që nuk ka qenë e mundur të jetë e panjohur për autoritetet hungareze; ...që përzgjedhja e kriminelëve të cilët duhej ta kryejnë atentatin në Marsejë është bërë në territorin hungarez, nga radhët e terroristëve të trajnuar posaçërisht.

Debati për këtë memorandum, i cili ka filluar më 7 dhjetor... vijoi në shenjë të këndvështrimeve të ashpra. Natën e 10 dhjetorit, pas bisedimeve të gjata dhe të mundimshme, lordi mbrojtës i vulës, si lajmërues, dorëzoi propozim informatë dhe rezolutë e cila u pranua njëzëri në Këshill. Rezoluta, duke u thirrur në obligimet e secilit shtet që të luftojë kundër terrorizmit dhe ruajtjes së integritetit territorial dhe pavarësisë së shteteve të tjera, e tërhiqte vëmendje për atë që disa përfaqësues të autoriteteve hungareze, duhet të mbajnë përgjegjësi për krimin në Marsejë, dhe kërkoi nga autoritetet hungareze t'i dënojnë ata përfaqësues të pushtetit të cilët mund të dëshmojnë si fajtorë”.

Raporti vjetor i Nevil Hendersonit, të dërguarit britanik në Beograd për vitin 1934, Z. Avramovski, Britanci o Kraljevini Jugoslaviji, t II, Zagreb 1988, 253-254.

Pyetje për Grupin 3

1. Duke e pasur parasysh kontekstin historik, përpiku të sqarosh cila ishte arsyeja për nxitjen e terrorizmit në Jugosllavinë mes dy luftërave botërore?
2. Cili ishte qëndrimi (i organizatave ndërkombëtare) të Lidhjes së Kombeve për çështjen e terrorizmit?
3. Cilat motive ishin më të përfaqësuara në vendosjen e individëve që të përcaktohen për terrorizëm?

Ustashët në trajnim

Ustashët gjatë trajnimit në Itali. Vllado Çernozevski në mes



Arhiv Jugoslavije, 14 – 27 – 72

Vrasësi i mbretit Aleksandër, Veličko Dimitrov Kerin (Vllado Çernozevski) në Itali në llogoren e ustashëve për trajnim

Bogdan Krizman, Pavelić i ustaše, Zagreb 1978, str. 128




Ante Paveliq në Itali në kampin trajnues të ustashëve

Bogdan Krizman, Pavelić i ustaše, Zagreb 1978, str. 128



Mbreti Aleksandër dhe ministri Louis Bartou



Arkivi i Jugosllavisë, përmbledhje fotografish

Atentati në Marsejë



Arkivi i Jugosllavisë, përmbledhje fotografish

Aspiratat territoriale të VMRO-së



Afise e VMRO-së
Teksti në afise: Македонија македонасве

Aspiratat territoriale të lëvizjes së ustashëve

NEZAVISNA Država HRVATSKA



Ustaški Poglavnik
Dr. Ante Pavelić
vodja hrvatskog oslobodilačkog pokreta.



Hrvatski narode!

U Novu Evropu mora ući Slobodna i Nezavisna Država Hrvatska na čitavom gore označenom području i Povjerenim HRVATSKIM poglavnik.

Stvaranje NEZAVISNE HRVATSKE DRŽAVE zastupali će na mirovnim pregovorima Dr. ANTE PAVELIĆ, ustaški glavnik, koji je već pred jedno desetljeće hrvatsku narodnu politiku usmjerio prema - danas pobjedničkoj Italiji i mačkoj i koji je JEDINI U STANJU osigurati sretnu budućnost HRVATSKOG NARODA.

Dajmo sve naše povjerenje Poglavniku Dru ANTI PAVELIĆU!

Afise e ustashëve

Teksti në afise:

Shteti i pavarur i Kroacisë

Udhëheqësi i ustashëve, Dr. Ante Paveliq, udhëheqës i Lëvizjes Çlirimtare Kroate

Popull kroat!

“Në Evropën e re duhet të futet edhe Shteti i Lirë dhe i Pavarur Kroat me tërë territorin popullor dhe historik të shënuar të mësipërm. Krijimin e shtetit të pavarur të Kroacisë në bisedimet paqësore do ta përfaqësojë Dr. Ante Paveliq, prijës i ustashëve i cili tanimë që para një dekade politikën popullore kroate e drejtoi drejt fitimtarëve të sotëm Italisë dhe Gjermanisë dhe i vetmi i cili është në gjendje ta sigurojë ardhmërinë e lumtur të popullit kroat.

T’ia japim të gjithë besimin tonë prijësit Dr. Ante Paveliq!”

Bogdan Krizman, Pavelić i ustaše, Zagreb 1978, str. 336.

Pyetje për diskutim final

1. Në kohën e depresionit të madh ekonomik, terrorizmi dhe lufta kundër terrorizmit shkaktuan humbje të mëdha financiare dhe investime të mëdha ushtarake. Përpiqu të sqarosh pse?
2. Deri në cilën masë terrorizmi e ndryshon situatën politike në vend?
3. A mund reagimi i shtetit të jetë ndryshe? Sqaro.
4. Kush e kërcënoi shtetin dhe në cilën mënyrë?
5. Krahaso cili ishte qëndrimi i (organizatave ndërkombëtare) Lidhjes së Kombeve gjatë këtyre ditëve, dhe vila ishte pozita e organizatave ndërkombëtare sot në lidhje me terrorizmin.